



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Neneve 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
2. Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe Nenit 4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
3. Kërkesën e KOSTT SH.A për derogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit të datës 24 maj 2010,
në seancën e mbajtur më 24 qershor 2010 ka nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **I lejohet** KOSTT SH.A. derogimi në zbatimin e dispozitave të neneve të **Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit** si në Shtojcë të këtij vendimi.
2. Të gjitha dispozitat tjera të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit të do të mbesin në fuqi.

ARSYETIM

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 24 maj 2010 ka pranuar kërkesën e KOSTT SH.A për derogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit. Gjatë vlerësimit të kërkesës dhe duke pasur parasysh gjendjen aktuale të Sistemit të Transmisionit, ZRRE ka pa të arsyeshme që të lejojë derogimin në afatet e vendosura si në Shtojcë.

Për raste të reja derogimi përfshinë afatet nga dita e aplikimit për derogim, ndërsa për rastet kur është lejuar derogimi më parë, afati vlen nga data e skadimit të derogimit paraprak.

Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e lejimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e lëshimit të tij ose në datën e publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Vendimit i bashkëngjitet Shtojca - Derrogimet e lejuara;

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, Kryesues

Theranda Beqiri, Anëtare

Përparim Kabashi, Anëtar

Blerim Koci, Anëtar
